



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	12.03.2024
REFERENC-Ë:	23/3679/MMPHI
PËR/ZA/TO:	N.P.T. "ISA PETROL" SH.P.K. Prizren Bazë e betonit
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për refuzimin e kërkesës për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, N.P.T "ISA PETROL" SH.P.K, Prizren për veprimtarinë: Bazë e Betonit, me Nr.prot. 23/3679/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

1. Vendimi për Refuzimin e Lejes Mjedisore për operatorin, N.P.T. "ISA PETROL" SH.P.K. Prizren, Bazë e betonit

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njesia org. Org.Jedinita Org.Unit: MMPHI
Nr. i Faqeve: 03
Br. Stranica: 03
No.Pages: 03

Nr. i Prot. Prot.No: 3679-2/28
Data: 19-04-24
Date: 19-04-24

PRISHTINË / A No.1





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.23/3679/MMPHI
Datë: 12.03.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit N.P.T. "ISA PETROL" SH.P.K. Prizren i refuzohet kërkesa për pajisje me Leje, për veprimtarinë: bazë e betonit në ngastrat nr. 8876, zona kadastrale, Prizren.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, N.P.T. "ISA PETROL" SH.P.K. Prizren për veprimtarinë: bazë e betonit në ngastren nr. 8876 zona kadastrale, Prizren, është konstatuar se Operatori nuk i plotëson kriteret e parapara me Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, pasi që mungojnë plotësimi i kushteve si në vijim:



- Operatori nuk ka sjell dëshmi për rregullimin e sipërfaqes operacionale;
- Ndërtimin e sistemit për grumbullimin e ujërave të lidhur me basenet sedimentuese dhe;
- I mungojnë vaskat që vendosen për të penguar rrjedhjen e aditivëve nga kontejnerët.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, merr Vendim për refuzimin e Lejes Mjedisore ne përputhje me nenin 12, paragrafi 3 te Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Prizren;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtjes e Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zaštitu Sredine i Voda / Department of Environment Protection and Waters

REFERENC-Ë:	23/3679/359/MMPHI-DMMU
DATË/A:	12.03.02024
PËR/ZA/TO:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
CC:	Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Abdullah Pirçe, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU
NGA/OD/FROM:	Fatlije Buza, kryesuese e komisionit për Leje Mjedisore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje lidhur me Leje Mjedisore për operatorin operatorit, N.P.T. "ISA PETROL" SH.P.K. Prizren, bazë e betonit

Te nderuar,

Bashkëlidhur gjeni lëndën me nr. Protokolli: nr. prot. 23/3679/359/MMPHI-DMMU, të operatorit " N.P.T. "ISA PETROL" SH.P.K. Prizren, bazë e betonit

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Životnu Sredinu i Vodu /
Department of Environment Protection and Water

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENC-Ë:	23/3679/359/MMPHI-DMMU					
PËR/ZA/TO:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI					
CC:	Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Abdullah Pirçe, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU					
NGA/OD/FROM:	Komisioni për Leje Mjedisore					
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje në kërkesën e operatorin " N.P.T. "ISA PETROL" SH.P.K. Prizren, Bazë e betonit					
Nr. i zyrës:	1517	Lokacioni:	Ish pallati i mediave	Data:	12.03.2024	
Br. kancelarije:		Kucni:	Rilindja, Prishtinë.	Datum:		
Room No.:		Extension:		Date:		
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION						<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL						<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE						<input checked="" type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS						<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS						<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION						<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED						<input checked="" type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED						<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN						<input checked="" type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION						<input type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE						

I nderuari Sekretar,

Komisioni për Leje Mjedisore i emëruar me Vendimin Nr. 7416/23, të dt. 22.12.2023, duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe neni 9 i Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, në afatin e paraparë ligjorë, jep këtë Mendim Profesional:

Operatori " N.P.T. "ISA PETROL" SH.P.K. Prizren Bazë e betonit, ka aplikuar për tu pajisur me Leje Mjedisore, me Nr. Prot 23/3679/359/ MMPHI-DMMU, për veprimtarinë: Bazë e Betonit, në ngastrën me nr. 8876 zona kadastrale, sipas Pëlqimit Mjedisor me Nr. 11/1676/2-ZSP-94/12 të lëshuar me dt. 17.05.2012.

Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrit të biznesit;
- Pëlqimin Mjedisor me Nr. 11/1676/2-ZSP-94/12 të lëshuar me dt.17.05.2012.
- Leje Ujore për shfrytëzimin e ujit, me nr.2479-2/23 - ZSP - 2023, të lëshuar me dt.25.09.2023
- Leje Ujore për shkarkimin e ujit, me nr.2478-2/23 - ZSP - 2023 , të lëshuar me dt. 25.09.2023;

Komisioni pas pranimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumentacionit dhe kushteve mjedisore si në vijim:

1. Aditivët të vendosen në vaska;
2. Te betonohet sipërfaqja operationale dhe
3. Të ndërtohet sistemi për grumbullimin e ujërave të lidhur me basenet sedimentuese;
4. Raporti e analizave të pluhurit;
5. Raportin e analizave të zhurmës.




Operatori nuk ka sjellë dëshmi, për plotësimin e kushteve për pikat: 1,2 dhe 3.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të operatorit në fjalë, në takimin e komisionit të mbajtur me dt. 12.03.2024, në përbërje prej tre (3) anëtarëve, unanimisht, konstatojnë se operatori nuk e ka sjellë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me

Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, neni 12, paragrafi 3 dhe si përfundim, rekomandon që të refuzohet Leja Mjedisore.

Bashkangjitur këtij Mendimi Profesional gjeni edhe propozim vendimin për Refuzimin e kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore.

Komisioni:

Fatlije Buza, kryesuese	
Adem Tusha, anëtar	Pushim vjetor
Fatmir Bytyqi, anëtar	
Përparim Terziu, anëtar	
Mentor Shala, anëtar	Nuk ishte prezent